



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 710/prot.
7

Tiranë, më 22.12.2022

VENDIM

Nr. 938, Datë 22.12.2022

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TERRA MINERALNA GNOJIVA D.O.O NGA SHOQËRITË YILDIRIM BALKAN FERTILIZER D.D. DHE YILDIRIM INTERNATIONAL FERTILIZER INVESTMENTS B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Terra Mineralna Gnojiva d.o.o nga shoqëritë Yildirim Balkan Fertilizer d.d. dhe Yildirim International Fertilizer Investments B.V.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Terra Mineralna Gnojiva d.o.o nga shoqëritë Yildirim Balkan Fertilizer d.d. dhe Yildirim International Fertilizer Investments B.V..

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Terra Mineralna Gnojiva d.o.o nga shoqëritë Yildirim

Balkan Fertilizer d.d. dhe Yildirim International Fertilizer Investments B.V.,

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen dhe shitjen e aksioneve të biznesit”, të nënshkruar më datë [...], palët janë:

Blerësi 1: Yildirim Balkan Fertilizer d.d. është një shoqëri aksionere e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me veprimtari të menaxhimit të shoqërive holding, biznesin e pasurive të paluajtshme, blerje dhe shitje të mallrave, përfaqësimi i kompanive të huaja, kontabilitet, etj, me aksioner të vetëm shoqërinë Yildirim International Fertilizer Investments B.V.

Blerësi 2: Yildirim International Fertilizer Investments B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, me aktivitet: shërbime financiare jo bankare¹.

Blerësit janë pjesë e grupit Yildirim, i cili aktualisht operon në industrinë metalurgjike dhe minierave, qymyrit dhe coke²; energjetike; prodhimin e plehrave kimike/ fertilizues dhe kimikate; menaxhim porti, transport dhe logjistikë; ndërtim dhe pasuri të paluajtshme; investime financiare dhe tregti ndërkombëtare.

Grupi Yildirim, është aktualisht aktiv në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë Albchrome Holding dhe dy filialeve të tij të zotëruara 100%, Albchrome SHPK dhe Vllahen Mining SHPK të cilët operojnë në sektorin minerar dhe në veçanti në prodhimin dhe furnizimin e ferrokromit dhe mineralit të kromit.

Shitësi 1: Ina-Industria Nafte d.d., është një shoqëri aksione sipas legjislacionit të Kroacisë, me objekt veprimtarie; nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror, prodhime kimike, mineral, plehëruesve dhe lidhjeve me azotin , furnizimi me avull dhe ujë të nxehtë, këshilla dhe blerje të software, etj.

Shitësi 2: Prvo Plinarsko Drustvo d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me objekt aktiviteti; projektim, ndërtimi, prodhimi i rrjetit të gazit, prodhimi dhe shpërndarja e energjisë termike, etj.

Target:

Terra Mineralna Gnojiva d.o.o., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me ortak shoqërinë Ina-Industria Nafte d.d., dhe shoqërinë Prvo Plinarsko Drustvo d.o.o. dhe objekt biznesi: blerja dhe shitja e mallrave, përfaqësimi i kompanive të huaja, ndërmjetësimi tregtar në tregjet e brendshme dhe të jashtme, konsulencë në lidhje me biznesin dhe menaxhimin, aktivitet e menaxhimit të shoqërisë mbajtëse, etj.

Duke qenë një shoqëri holding Terra Mineralna Gnojiva d.o.o. nuk është aktive në asnjë treg përkatës dhe nuk gjeneron asnjë të ardhur në Shqipëri.

Terra Mineralna Gnojiva d.o.o., zotëron 54.52% të kapitalit aksioner të shoqërisë Petrokemija, d.d.

¹ Financial holdings

² Lëndë djegëse e ngurtë e prodhuar nga ngrohja e qymyrit në mungesë të ajrit, në mënyrë që përbërësit e paqëndrueshëm të largohen.

Petrokemija, d.d. është një shoqëri aksionere e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, e angazhuar në prodhimin e plehrave minerale duke përdorur lëndë të para minerale natyrore, gaz natyror, azot atmosferik dhe oksigjen.

Petrokemija, d.d. ka në zotërim tre filiale, të cilat janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të themeluara sipas legjislacionit të Kroacisë: Tvornica Gline Paleta Kutina d.o.o., Tvornica Paleta Kutina d.o.o. dhe Luka Sibenik, d.o.o.

II. Përqendrimi

Më datë [...], shoqëritë Yildirim Balkan Fertilizer d.d. dhe Yildirim International Fertilizer Investments B.V., në cilësinë e blerësit, shoqëritë Ina-Industrija Naftë d.d. dhe Prvo Plinarsko Drustvo d.o.o., në cilësinë e shitësit, dhe shoqëria Yildirim Holding A.S, në cilësinë e garantuesit të blerësit, kanë nënshkruar “Marrëveshje për blerjen dhe shitjen e aksioneve të biznesit”.

Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe në përfundim të transaksionit, shitësit synojnë të shesin dhe të transferojnë XX% të aksioneve të biznesit të targetit tek shoqëria Yildirim Balkan Fertilizer d.d. dhe XX% të aksioneve të biznesit të targetit tek shoqëria Yildirim International Fertilizer Investments B.V.

Me blerjen e aksioneve të targetit, blerësit do të blejnë në mënyrë indirekte aksionet në shoqërinë Petrokemija, d.d. dhe aksione biznesi në filialet e Petrokemija, d.d., të mbajtura nga shoqëria Terra Mineralna Gnojiva d.o.o.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria Yildirim Balkan Fertilizer d.d. dhe shoqëria Yildirim International Fertilizer Investments B.V., do të zotërojnë 100% të kuotave në kapitalin e shoqërisë Terra Mineralna Gnojiva d.o.o. dhe 54.52% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë Petrokemija, d.d.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar, transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe furnizimit të plehrave kimikë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitimi i kontrollit të plotë mbi shoqërinë Terra Mineralna Gnojiva.d.o.o. dhe 54.52% të aksioneve të shoqërisë Petrokemija, d.d., nga shoqëria Yildirim Balkan Fertilizer d.d. dhe shoqëria Yildirim International Fertilizer Investment B.V., shoqëri të Grupit Yildirim. Grupi Yildirim është aktiv në Shqipëri, vetëm në tregun minerar të prodhimit dhe furnizimit të ferrokromit dhe kromit, nëpërmjet filialit të tij Albchrome Holding SHPK.

Terra Mineralna Gnojiva d.o.o. është një shoqëri holding, kroate, e cila nuk kryen asnjë aktivitet tregtar, por nëpërmjet shoqërisë Petrokemija d.d., operon në tregun e prodhimit dhe furnizimit të plehrave kimikë. Asnjë nga shoqëritë e targetit nuk kanë prezencë juridike dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Terra Mineralna Gnojiva d.o.o nga shoqëritë Yildirim Balkan Fertilizer d.d. dhe Yildirim International Fertilizer Investments B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA  Zv/Kryetar	Rezana KONOMI  Anëtar	Adriana BERBERI  Anëtar	Durim KRAJA  Anëtar
---	---	--	---


Denar BIBA
Kryetar